

URDHËR
Nr. 121, datë 1.9.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 258, datë 27.4.2023, “Për përcaktimin e kushteve, kriterëve, procedurave të shqyrtimit dhe të vendimmarrjes, formatit dhe afateve për dhënien e autorizimit për përdorim civil të lëndëve plasëse”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Ami Kozeli, për nënshkrimin e:

a) aktmiratimeve dhe aktrefuzimeve për aplikimet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për t’u pajisur me leje minerare;

b) njoftimeve për fillimin e procedurave të revokimit të lejeve minerare;

c) njoftimeve për ndërprerjen e procedurave të fillimit të revokimit të lejeve minerare;

d) vendimeve për revokimin e lejeve minerare;

e) akteve për pasqyrimin dhe miratimin e ndryshimeve të të dhënave në lejet minerare;

f) aktmiratimeve dhe aktrefuzimeve për zgjatjen e afateve, ndryshimin e koordinatave, transferimin e lejeve minerare;

g) akteve të dhënies së të drejtës së aplikimit në QKB, për zonat e hapura për qëllime publike;

h) akteve për miratimin e nënkontraktimeve;

i) shkresave të korrespondencës me QKB-në për sektorin mineral;

j) miratimit/refuzimit të aplikimeve për autorizimet për personat juridikë privatë ose publikë, vendas apo të huaj, për përdorim civil të lëndëve plasëse;

k) urdhrave për kthimin/moskthimin e garancive financiare të rehabilitimit dhe investimit;

l) urdhrave për miratimin e projekteve shtesë të veprimtarive minerare.

2. Në ushtrimin e kompetencave të deleguara, sipas pikës 1, të këtij urdhri, zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Ami Kozeli, ndjek dhe zbaton parashikimet e ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 258, datë 27.4.2023, “Për përcaktimin e kushteve, kriterëve, procedurave të shqyrtimit dhe të vendimmarrjes, formatit dhe afateve për dhënien e autorizimit për përdorim civil të lëndëve plasëse”; të vendimit nr. 942, datë 17.11.2010, “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”, të ndryshuar; të vendimit nr. 741, datë 9.9.2015, “Për miratimin e formës, rasteve të kthimit dhe mënyrës së llogaritjes të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e investimit në veprimtarinë minerare”, të ndryshuar; dhe të udhëzimit nr. 17, datë 28.1.2015, “Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e nënkontraktimit të së drejtës së lejes minerare, për kërkim-zbulim, për shfrytëzim apo për kërkim-zbulim-shfrytëzim”.

3. Kompetenca e deleguar, sipas pikës 1, do të ushtrohet nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri deri në miratimin e një urdhri të dytë.

4. Urdhri nr. 210, datë 30.9.2024, i zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Ami Kozeli, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE MINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku